

KOSOVO



KOMITETI OLIMPIK  
OLYMPIC COMMITTEE  
Nr. 681/2020  
Dt. 02.04.2020  
KOSOVA

**KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS  
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE**

*Prishtinë, 02.04.2020*

**Nga:** Komiteti Olimpik i Kosovës

**Lënda:** Informatë Publike rreth implementimit të Kodit të WADA-s dhe Rregullave të NADO-s në Kosovë;

Përmes këtij dokumenti, Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës informon të gjithë dashamirësit e sportit, duke përfshirë, Federatat Sportive, sportistët, klubet, trajnerët, prindërit e sportistëve, fizioterapeutët sportistë, udhëheqësit e Komunave në sektorët e sportit dhe cdo individ tjetër i përfshirë në fushën e sportit, se KOK që nga Marsi i vitit 2019 ka filluar implementimin e Rregullave të Kodit të WADA-s “Organizatës Botërore të Anti-Dopingut” si dhe Rregullat e NADO-s “Organizatave Kombëtare të Anti-dopingut”.

Komiteti Olimpik i Kosovës deri në themelimin e Agjencisë Kombëtare të Anti-Dopingut nga qeveria e Republikës së Kosovës, do ta ketë rolin e përkohshëm të këtij Agjencioni në Territorin e Kosovës.

Të gjitha informatat në lidhje me dokumentet dhe rregulloret e Anti-Dopingut, udhëzimet e ndryshme, substancat dhe metodat e ndaluara, aktivitetet e KOK-ut në lidhje me sportin e pastër dhe kampanjat e tjera vetdijësuese, mund t`i gjeni në web faqe të KOK-ut, në linkun e bashkangjitur më poshtë.

<https://www.noc-kosovo.org/sq/anti-doping>

Besim Hasani,  
President